



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
MINISTRIA E ARSIMIT  
DHE SPORTIT  
AGJENCIA KOMBETARE E PROVIMEVE

PROVIMI I MATURËS SHTETËRORE 2015

I DETYRUAR

SKEMA E VLERËSIMIT TË TESTIT

VARIANTI A

Lënda: Letërsi e thelluar

Fishta: "Lahuta e Malcisë"

Gavril Dara (I Riu): "Kënga e Beratit"

Pyetja 1	D	1 pikë
Pyetja 2	A	1 pikë
Pyetja 3	B	1 pikë
Pyetja 4	A	1 pikë
Pyetja 5	B	1 pikë

Pyetja 6 3 pikë

➤ **Detaje të karakterit:**

- Oso Kuka: mikpritës, besnik (ndaj mikut), kreshnik, i pafrikë, njeri i fjalës.

**OSE**

(citime drejtpërdrejt nga fragmenti)

*qi me t ka pasë da bukën; qi u ka ruejtun mal e vërri; qi u ka mprohjtun erz e ship.*

➤ **Detaje fizike**

- Pal Golemi: vetullat e trasha, sytë e zgurdulluar.

➤ **Shpjegimi:**

Imazhi që përcjell portretizimi i dy personazheve është pamja e një kreshniku hijerëndë, burrëror, por me tipare fisnike, (mikpritja, besnikëria).

**OSE**

**Imazhi i përftuar në të dy rastet:** heronj me zemër të fortë, besnikë, që luftojnë në emër të nderit e besës, të ashpër me armikun, heronj të ngjashëm me ata të Eposit të Kreshnikëve. Heronj që përmbushin përfytyrimin e popullit për trimat shqiptarë.

**1 pikë** Nëse zbulon një detaj të karakterit të Oso Kukës

**1 pikë** Nëse zbulon një detaj fizik të Pal Golemit.

**1 pikë** Nëse shpjegon imazhin që përftohet.

**0 pikë** Nëse përgjigjja e dhënë nuk i përmbahet thelbit të pyetjes ose nuk ka përgjigje.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 7 4 pikë**

- Elementi mitologjik: **zanat (element mitologjik - Cikli i kreshnikëve)**
- **Shpjegimi:**

Zakonisht zanat janë me pamje magjepsëse, të bukura dhe tekanjoze, por në këtë fragment është krejt e kundërta: janë humane, ndiejnë dhimbje për humbjen e Oso Kukës: “Kjani, kjani, oj Zana, kjani...”

Vajtojnë për humbjen e një kreshniku, si nëna për të birin.

Konteksti është dramatik, shqiptarët ndodhen përballë një sulmi nga ushtritë armike, madje edhe të tradhtuar në besën e tyre nga shkjetë e Vraninës që u bashkuan me ushtrinë e Cetinës.

Drama është e tillë që autori thërret zanat e malit që të bëhen pjesë e vajit të madh.

- Atmosfera është e rëndë, e dhimbshme, e trishtë.
- Tonet janë lirike të përvajshme (elegjiake).

**1 pikë** Nëse identifikon elementin mitologjik.

**1 pikë** Nëse shpjegon kontekstin ku shpaloset ky ndikim.

**1 pikë** Nëse identifikon atmosferën e krijuar.

**1 pikë** Nëse identifikon tonet që e përshkojnë fragmentin.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 8 4 pikë****Kënga I**

- Rimë e puthur (AA BB);
- Shpjegimi:

Ruan vijën melodike, i ngjashëm me këngët e eposit të kreshnikëve, e thjeshtë për t’u mbajtur mend dhe për të kryer misionin e saj që të ndërjegjësojë shqiptarët për origjinën e tyre.

Krijon larmishmëri dhe muzikalitet.

**Kënga II**

- Rimë e bardhë (mungesë rime).
- Shpjegimi:

I jep poemës trajtën e një rrëfimi të shtruar, i cili edhe pse në vargje, ka ritmikën e një proze.

**2 pikë** Nëse identifikon rimën për secilin fragment.

**2 pikë** Nëse shpjegon të veçantën e përdorimit të secilës prej tyre në fragmentin përkatës.

**0 pikë** Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 9**                      **2 pikë****Kënga I**

- Mendësia e tipit popullor: heronjtë e këngës janë të fuqishëm, të shpejtë, ata janë të gatshëm të hidhen në ballë të rrezikut, janë të besës, kur japin falën, ata janë gati ta mbrojnë atë me jetë. Krahasimet dhe hiperbolat janë të tipit popullor

➤ **Kënga II**

Gjendja e rënduar fizike, por heroike shpirtërore, është e ndërtuar mbi bazën e përfytyrimit të popullit për heroin, i cili do të vdesë tek dhe i të parëve, duke lënë amanetin për pasardhësit.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon për fragmentin I ndikimin nga mendësia popullore.

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse shpjegon për fragmentin II ndikimin nga mendësia popullore.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Sabri Godo****Skënderbeu**

Pyetja 10	C	1 pikë
Pyetja 11	B	1 pikë
Pyetja 12	A	1 pikë
Pyetja 13	B	1 pikë
Pyetja 14	D	1 pikë

**Pyetja 15**                      **2 pikë**

- **Tiparet e dialogut:**

Replikat janë të shkurtra, të shpejta, lakonike, të drejtpërdrejta, të figurshme.

- **Funksioni:**

Ky dialog shërbejnë si mjet **karakterizimi për personazhet.**

Skënderbeu fiton përmasat e një prijësi që merr vendime të prera e në kohë. Dialogu i tij i prerë në këtë fragment, i sjellë përmes një gjuhe të zgjedhur, ndryshon nga ai i fjalimeve të gjata e sugjestionuese.

**1 pikë**                      Nëse identifikon një ndër tiparet e dialogut.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon funksionin e tij.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 16**                      **2 pikë**

- **Siguria e Skënderbeut** duhet kërkuar tek aftësitë prej strategu të tij, te pushteti dhe dashuria që gëzonte tek ushtarët, tek aftësitë luftarake, organizative dhe oratorike si dhe tek përvoja në luftime.

➤ **Momentet:**

*Skënderbeu nuk u tërhoq dhe pranoi për herë të parë dhe kundër strategjisë së tij, një ndeshje të hapur me fuqinë e përqendruar të sulltanit.*

*Skënderbeu hodhi në të gjithë fuqinë e tij të lëvizshme, ushtrinë prej pesëmbëdhjetë mijë vjetësh.*

*Ai duhej të pengonte marshimin armik dhe t'i jepte kohë popullit të tërhiqej.*

*Kishte humbur njëmijë të vrarë e të plagosur rëndë, por ai dhe tërë ushtria e tij kishin dalë nga ajo gropë e zjarrit me sytë të ndezur dhe shpirtin lart.*

**1 pikë**                      Nëse tregon se nga buron siguria te Skënderbeu.

**1 pikë**                      Nëse zbulon në fragment një moment ku përcillet një cilësie tillë.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 17**                      **2 pikë****Tiparet epike:**

- gjendje e tensionuar e situatës;
- angazhim i forcave kundërshtare të fuqishme;
- një hero veprues që mund të ndryshojë tërësinë e veprimeve, me një individualitet të madh e rol përcaktues në vepër;
- heroi karakterizohet nga besimi në fitore;
- e ardhmja përcaktohet nga lufta e përmasave të mëdha;
- ka shtrirje të madhe të veprës nga qendra drejt një horizonti më të gjerë.

**2 pikë**                      Nëse identifikon dy tipare epike që shfaqen në këtë fragment.

**1 pikë**                      Nëse identifikon vetëm një tipar epik.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

**Pyetja 18**                      **2 pikë**

- **Qëndrimi:** manipulues, i fshehin të vërtetat e ngjarjeve (historike).
- **Shpjegimi:**

Kronistët e Perandorisë Turke shkruajnë historinë dhe natyrisht kjo histori duhet dhënë sipas këndvështrimit të tyre. Kjo Perandori e ka të vështirë ta pranojë humbjen përballë një ushtrie dhe populli kaq të vogël, ndaj manipulojnë gjithçka. Për ta është e pamundur ta pranojnë realitetin. *Kronistët janë pjesë e saj dhe nuk i qëndrojnë besnikë së vërtetës, pasi e vërteta në këtë rast dhemb.*

**1 pikë**                      Nëse tregon qëndrimin e kronistëve turq.

**1 pikë**                      Nëse shpjegon këtë qëndrim të tyrin.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 19**                      **3 pikë**

- Leka ishte entuziast, me besim të palëkundur në fitore dhe krenar, më emocional përkundër Moisiut të heshtur, dyshues, me një krenari të heshtur dhe më i përmbajtur. Ata ishin të dy luftëtarë të zotë dhe të etur për lavdi.
- Skënderbeu përballë tyre paraqitet i dhembshur dhe i fuqishëm.

**2 pikë**                      Nëse portretizon në plan krahasues të dy luftëtarët (të përbashkëtat dhe dallimet).

**OSE**

**1 pikë**                      Nëse jep vetëm të veçantat (ose vetëm të përbashkëtat).

**DHE**

**1 pikë**                      Nëse tregon se si paraqitet Skënderbeu në raport me ta.

**0 pikë**                      Nëse përgjigjet gabim ose nuk përgjigjet fare.

*Nxënësi do të marrë pikë edhe kur në përgjigjen e dhënë, jep një shpjegim që nuk e përmban modeli i përgjigjes, por që komisioni i vlerësimit e gjykon të saktë.*

**Pyetja 11****6 pikë**

Për esenë do të ndiqen kriteret e mëposhtme:

**KRITERI I: SHTJELLIMI I IDESË****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- shkruan një ese, ku krahason figurën e Skënderbeut në veprën e Godos me atë në veprën e një shkrimtari tjetër.
- përdor detaje të marra nga veprat;
- ka qartësi mendimi.

**KRITERI II: ORGANIZIMI DHE STRUKTURA E ESESË****1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- respekton elementet e strukturës së esesë:
  - hyrjen
  - zhvillimin
  - përfundimin

**KRITERI III: STILI DHE ORIGJINALITETI****2 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- përmes gjuhës që përdor, krijon një përshtypje të përgjithshme për atë që do të shprehë.
- shprehet me një gjuhë eseistike.
- ka fjalor të pasur.
- stil origjinal.

**KRITERI IV: SAKTËSIA GJUHËSORE****1 pikë**

Vlerësuesi do të shikojë nëse nxënësi:

- strukturon qartë përgjigjen nga pikëpamja gramatikore.
- ndërton fjali që janë të sakta dhe të qarta.
- përdor fjali që variojnë në modele, gjatësi dhe ritëm.
- ka saktësi drejtshkrimore.